

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. H. nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.625/2016 të dt. 18.07.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare gjyqesore, në prezencën e Prokurorit Themelore në Prizren Elfete Purova, të akuzuarit, me datë **19.06.2017**, morri dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A. H. nga i ati I. , e ëma M. , e vajzërisë M. i lindur më dt. në Prizren, ku edhe jeton ne lagjen Dardania rr. nr. , i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, menagjer i shitjes, eshte i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me dt.13.03.2016 rreth ores 21,00, ne Prizren, ne lagjen D. , pa autorizim posedon narkotik, substanc psikotrope ose analoge, ne ate menyre qe gjate patrollimit te policis jane verejtur 3 persona te cilet jane dyshuar per perdorimin e substancave narkotike, ku i pandehuri A. H. me te verejtur policin, substancen narkotike e gjuan ne toke, e cila substanc me pas sekuestrohet nga policia, ku ne baze te raportit te ekzaminimit AFK/2016-0921/2016-755 te dt.01.06.2016, ka rezultuar te jete kanabis (marihuane), qe permban tetrahidrokanabinol (THC), ne peshe te pergjithshme prej 2.94+0.0001 gr,

-kësodore ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 41, 46, 62, e 69, 73, 74, 75, 76 dhe 365 të KPK-ës, te akuzuarit i shqipton,

D E N I M M E G J O B Ë

Ne lartesi prej **300 /treqinde/ Euro** te cilen shume te denimit i akuzuari eshte i obliguar te paguaj ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi, denimi do te paguhet ne 3 kiste, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njejt do te zevendesohet me denim burgu duke llogaritur per çdo 20 Euro nje dite burg, rrespektivisht 15 dite burgim.

I akuzuari obligohet qe ne emer te shpenzimeve te paushallit gjyqesor te paguaj shumen **prej 30 Euro**, te gjitha keto ne afte prej 15 ditesh, prej dites se plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.



Te akuzuarit gjykata konform dispozitive te nenit 62 par.1 e 2 p.2.7 dhe nenit 69 te KP-es, krahas denimit kryesor i shqiptohet edhe denimi plotesues dhe ate marrjen – konfiskimin e nje qese najlloni me substanc narkotike te llojit (mariuhan), ne peshe prej 2.94+0.0001 gr.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP.nr. 625/2016 te dt.18.07.2016, kunder te akuzuarit A. H. nga Prizreni, per shkak te vepres penale posedim i paautorizuar i narkotikve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 te KPK-es.

Gjykata ne shqyrtim kryesor ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajesis per vepren penale e cila i vihete ne bare, e qe pranimi i fajesis eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale posedim i paautorizuar i narkotikve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 te KPK-es dhe per kete gjykata te akuzuarin i shpalli fajtores dhe i shqiptoi denimin me kusht, paraprakisht duke i vertetuar pergjegjesin e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjelljen korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, me pare i pa gjykuar, si dhe ne kuptim te nenit 74, 75 e 76 gjykata morri per baze faktin qe i akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tij ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, ka shprehur keqardhje per shkak te vepres se kryer, ka pasur sjellje korrekte ne gjykate, i premtonte gjykates se me shume se 1 vit nuk e perdor me narkotikun, andaj gjykata i shqiptoi denimin me gjobe sepse konsideron se me shqiptimin e denimit do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete i kujdesshem dhe do te permbahet nga veprimet e tilla te karakterit penal.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 450, e 451 te KPPK-se.

Mbi marrjen e sendit – konfiskimin, gjykata vendosi konform nenit 62 e 69 te KP-es,

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr. 1524/2016 të dt. 19.06.2017

**Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari
Fatmir Krasniqi**



UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgykimi palet e pakenaqura kanë te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.